

TREGUESIT DEMOGRAFIKË

Tremujori II – 2026

Në tremujorin e dytë të vitit 2026, shtesa natyrore e popullsisë rezultoi pozitive me 218 lindje më shumë se vdekje, ku:

- numri i lindjeve për tremujorin e dytë 2026 është 5.083, duke shënuar një rënie me 3,0 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2025;
- numri i vdekjeve për tremujorin e dytë 2026 është 4.865, duke shënuar një rënie prej 3,7 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2025.

FIG. 1 SHTESA NATYRORE -TREMUJORE




* Të dhëna paraprake

Në tremujorin e dytë 2026, pesë qarqe të vendit regjistrojnë shtesë natyrore pozitive të popullsisë, ndërsa në shtatë qarqet e tjera shtesa natyrore e popullsisë është negative.

Qarku me shtesën natyrore më të lartë është Tirana me 1.033 lindje më shumë sesa vdekje, ndërsa qarku me shtesën natyrore më të ulët është Korça me 265 vdekje më shumë sesa lindje.

FIG. 2 LINDJET, VDEKJET DHE SHTESA NATYRORE SIPAS QARQEVE, T2 – 2026*



* Të dhëna paraprake

LINDJET

Në tremujorin e dytë 2026, nëntë qarqe të vendit regjistrojnë rritje të numrit të lindjeve, ndërsa tre qarqe të tjera shënojnë ulje, në krahasim me tremujorin e dytë të vitit 2025.

Qarku Tiranë paraqitet me numrin më të lartë të lindjeve, duke regjistruar 2.310 lindje, ndërsa qarku Gjirokastrë paraqitet me numrin më të ulët me 66 lindje.

Qarku Dibër regjistron rritjen më të lartë në përqindje të lindjeve me 14,6 %, ndërsa rënien më të theksuar e regjistron qarku Tiranë me 12,0 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2025.

VDEKJET

Në tremujorin e dytë 2026, tre qarqe të vendit regjistrojnë rritje të numrit të vdekjeve, ndërsa nëntë qarqe të tjera shënojnë ulje, në krahasim me tremujorin e dytë të vitit 2025.

Numri më i lartë i vdekjeve është regjistruar në qarkun e Tiranës me 1.277 raste, ndërsa numri më i ulët në qarkun e Kukësit me 97 raste.

Qarku Durrës regjistron rritjen më të lartë në përqindje të vdekjeve me 10,4 %, ndërsa rënien më të theksuar e regjistron qarku Kukës me 22,4 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2025.

Shënim për përdoruesit:

- Në zbatim të Politikës së Trajtimit të Gabimeve, INSTAT ndërmerr pa vonesë korrigjimin e çdo gabimi të identifikuar në statistikave zyrtare të publikuara. Përdoruesit informohen në mënyrë të menjëhershme dhe transparente për korrigjimet dhe ndryshimet e reflektuara, në përputhje me parimet e paanshmërisë, transparencës dhe cilësisë së statistikave zyrtare. Politika e plotë e Trajtimit të Gabimeve është e disponueshme në adresën: <https://www.instat.gov.al/media/9577/politika-e-trajtimit-te-gabimeve.pdf>
- Të dhënat e detajuara janë të disponueshme në databazën statistikore të INSTAT: [Lindjet, Vdekjet](#)

Metodologjia

Shënime metodologjike

Të dhënat tremujore për lindjet dhe vdekjet, në nivel kombëtar dhe qarku, përbëjnë një hallkë të rëndësishme të demografisë së vendit. Ato paraqesin të dhëna mbi ndryshimet në popullsi, të cilat kanë impakt në jetën ekonomike dhe sociale të vendit. Këto të dhëna publikohen mbështetur në Programin e Statistikave Zyrtare 2022-2026.

Lindjet

Të dhënat e lindjeve

Të dhënat e lindjeve sipas karakteristikave bazë demografike sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, e cila dërgon në INSTAT vetëm numrin e lindjeve të banuesve në Shqipëri.

Konsiderohen të gjitha lindjet e banuesve në Shqipëri gjatë periudhës referencë, duke mos marrë parasysh lindjet e banuesve jashtë Shqipërisë (emigrantëve), edhe pse mund të regjistrohen në zyrat e gjendjes civile, pranë ish-vendbanimeve të tyre.

Regjistrimet e vona të lindjeve

Kryhet një rregullim i vogël i numrit të lindjeve që regjistrohen vonë për vitin aktual, në mënyrë që të përfshijmë të gjitha lindjet e ndodhura në periudhën referencë.

Numri i lindjeve të regjistruara vonë nga viti i mëparshëm janë konsideruar si një proxy për regjistrimet e vona të vitit aktual, duke konsideruar supozimin (si rezultat edhe i analizave tona të vazhdueshme) që numri i regjistrimeve të vona të lindjeve nuk ndryshon shumë nga viti në vit.

Vdekjet

Të dhënat e vdekjeve

Të dhënat e vdekjeve, sipas karakteristikave bazë demografike sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, e cila dërgon në INSTAT vetëm numrin e vdekjeve të banuesve në Shqipëri.

Konsiderohen të gjitha vdekjet e banuesve në Shqipëri gjatë periudhës referencë, duke mos marrë parasysh vdekjet e banuesve jashtë Shqipërisë (emigrantëve), edhe pse mund të regjistrohen në zyrat e gjendjes civile pranë ish-vendbanimeve të tyre.

Regjistrimet e vona të vdekjeve

Bëjmë një rregullim të vogël të numrit të vdekjeve që regjistrohen vonë për vitin aktual, në mënyrë që të përfshijmë të gjitha vdekjet e ndodhura në periudhën referencë.

Numri i vdekjeve të regjistruara vonë nga viti i mëparshëm janë konsideruar si një proxy për regjistrimet e vona të vitit aktual, duke konsideruar supozimin (si rezultat edhe i analizave tona të vazhdueshme) që numri i regjistrimeve të vona të vdekjeve nuk ndryshon shumë nga viti në vit.

Përkufizime¹

Shtesa natyrore e popullsisë: Shpreh rritjen/rënien e popullsisë, si rezultat i proceseve biologjike (lindjeve dhe vdekjeve) të saj, gjatë një periudhe kohe.

Ky tregues shprehet si diferencë ndërmjet lindjeve dhe vdekjeve.

Lindje e gjallë: Lindje e fëmijës që shfaq shenja jete.

Vdekje: Nënkupton zhdukjen e përhershme të të gjitha shenjave të jetës, në çdo kohë pasi ka ndodhur një lindje e gjallë (ndërprerjen e funksioneve vitale, pa aftësinë e ringjalljes).

¹ Shiko metodologjinë në linkun në vijim: <https://www.instat.gov.al/sq/temat/treguesit-demografike-dhe-sociale/lindjet-vdekjet-dhe-martesar/#tab4>